



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesat e Palëve për Ndryshimin e Afateve

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹, bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht, “Kërkesa” dhe “ZPS-ja”)² për zgjatjen e afatit për paraqitjen e përgjigjes ndaj Apelit të Pjetër Shalës, (përkatësisht, “Përgjigjja”, “Shala” dhe “Apeli”) ³ kundër “Vendimit mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (“Vendimi i Kundërshtuar”).⁴ ZPS-ja kërkon një zgjatje prej dhjetë ditësh për dhënien e Përgjigjes, pra deri më 29 nëntor 2021.⁵ Shala u përgjigj se ai nuk e kundërshton Kërkesën, dhe kërkon një zgjatje prej pesë ditësh për të paraqitur Kundërpërgjigjen e tij ndaj Përgjigjes, pra deri më 9 dhjetor 2021 (përkatësisht, “Përgjigjja ndaj Kërkesës” dhe “Kundërpërgjigjja”).⁶

1. ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e Kërkesës, që është e arsyeshme dhe proporcionale.⁷ Ajo thekson rëndësinë, kompleksitetin dhe risinë e problemeve të ngritura në këtë çështje gjyqësore, nevojën për të dhënë parashtrime të përqendruara dhe të plota, si dhe ndeshjen e afateve me të cilat

¹ F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 10 Nëntor 2021.

² F00005, Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit, 15 nëntor 2021 (“Kërkesa”).

³ F00003, Apel i Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 9 Nëntor 2021 (“Apeli”). Paneli i Apelit vëren se ka miratuar kërkesën e Shalës për zgjatjen e afatit për paraqitjen e Apelit deri më 8 nëntor 2021; shih F00002, Vendim mbi Kërkesën e Shalës për Ndryshim Afati, 28 Tetor 2021 (“Vendim për Ndryshimin e Afatit Apelit”), para. 5. Apeli u paraqit më 9 nëntor 2021, disa sekonda pas mesnatës. Për shkak të natyrës *de minimis* të shkëljes së afatit të ndryshuar, Paneli i Apelit e pranon Apelin si të vlefshëm, sipas rregullës 9(5)(b) të Rregullores.

⁴ F00088, Vendimi mbi Mocionin që ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuar, 18 tetor 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁵ Kërkesa, para 1, 3.

⁶ F00006, Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit, 16 Nëntor 2021 (“Përgjigjja ndaj Kërkesës”), para 1-2.

⁷ Kërkesë, para. 2.

përballet në këtë çështje gjyqësore.⁸ Së fundmi, ZPS-ja parashtron se kërkesa për zgjatjen e afatit është proporcionale me atë të miratuar në lidhje me Apelin, se Mbrojtja nuk kundërshton Kërkesën dhe se ZPS-ja nuk ka kundërshtime për një zgjatje të arsyeshme për afatin për t'iu kundërpërgjigjur Përgjigjes së saj.⁹

2. Shala përgjigjet se ka arsye të vlefshme edhe për zgjatjen e afatit për Kundërpërgjigjen për shkak të rëndësisë dhe kompleksitetit të problemeve të ngritura në Apel dhe afatet e njëkohshme dhe detyrimet procedurale me të cilat ai po përballet.¹⁰ Ai gjithashtu kujton se ZPS-ja nuk kundërshton ndryshimin e këtij afati.¹¹

3. Paneli vëren se, sipas rregullës 170(1) të Rregullores, një kundërpërgjigje ndaj Apelit duhet të paraqitet normalisht deri më 19 nëntor 2021. Paneli gjithsesi sjell në vëmendje se rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e çdo afati të përcaktuar në Rregullore kundrejt paraqitjes së një arsyeje të vlefshme ose *proprio motu*.

4. Paneli i Apelit konstaton se ekziston një arsye e vlefshme për miratimin e ndryshimit të afateve për Përgjigjen dhe Kundërpërgjigjen bazuar në rëndësinë dhe kompleksitetin e problemeve që trajtohen në Vendimin e Kundërshtuar, si dhe risinë në këtë çështje para Apelit. Paneli i Apelit gjithashtu pranon se palët aktualisht po përballen me ndeshje afatesh dhe vëren se një zgjatje e ngjashme afati u miratua në lidhje me Apelin.¹²

5. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesën si dhe Përgjigjen ndaj Kërkesës;

⁸ Kërkesa, para. 2.

⁹ Kërkesa, para 1-3.

¹⁰ Përgjigja ndaj Kërkesës, para. 2.

¹¹ Përgjigja ndaj Kërkesës, para. 2.

¹² Vendim për Ndryshimin e Afatit të Apelit, para 3, 5. Paneli vëren se Shala nuk ka faktuar pretendimet e tij se ai po përballet me “një sërë afatesh të njëkohshme dhe detyrime procedurale”; shih Përgjigjen ndaj Kërkesës, para. 2. Sidoqoftë, në këtë rast Paneli i Apelit nuk do t'i japë rëndësi kësaj mangësie, ndër të tjera për faktin që ZPS nuk ka kundërshtime për kërkesën e Shalës për ndryshimin e afatit.

AUTORIZON ZPS-në që të paraqesë Përgjigjen e saj jo më vonë se 29 nëntor 2021; dhe

AUTORIZON Shalën që të paraqesë Kundërpërgjigjen e tij jo më vonë se 9 dhjetor 2021.

/nënshkrim/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E enjte, 17 nëntor 2021

Në Hagë, Holandë